



**DEPARTAMENTI I MJEKËSISË LIGJORE
EULEX-KOSOVË**

**RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE TE EULEX-DML
OPERACIONET PËR PERSONAT E ZHDUKUR**

PERIUDHA E RAPORIMIT: 9 DHJETOR 2010 – 8 DHJETOR 2011 (2012-DML-005)

Ky raport paraqet rezultatet e aktiviteteve të ndërmarra nga EULEX-DML si pjesë e operacioneve për personat e zhdukur për periudhën 9 dhjetor 2010 deri më 8 dhjetor 2011. Raporti është i ndarë në këta kapituj:

- Kapitulli 1- Rezultatet nga operacionet fushore
- Kapitulli 2- Rezultatet e antropologjisë mjeko-ligjore dhe të identifikimit
- Kapitulli 3- Të zhdukurit: raporti i situatës
- Kapitulli 4- Monitorimi, udhëzimi dhe këshillimi (MUK) dhe ngritja e kapaciteteve vendore
- Kapitulli 5- Plani i punës 2012
- Kapitulli 6- Rekomandime
- Anekset 1-2

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Operacionet për personat e zhdukur:

Në vitin 2011 ekspertët mjekoligjor të EULEX-it që punojnë në Departamentin e Mjekësisë Ligjore (EULEX-DML) kanë zhvilluar 84 operacione fushore dhe kanë gjetur 42 individë. Janë identifikuar **pesëdhjetë e një (51) persona të zhdukur. Familjeve përkatëse u janë kthyer 79 mbetje mortore.** Një analizë e plotë e mbetjeve të pidentifikuara është ende duke vazhduar. Janë përzgjedhur 278 mostra eshtrash për analizën e ADN-së.

Për vitin 2012, janë identifikuar mbi **30 raste** me lokacione potenciale për operacione fushore. Përveç kësaj, do të përfundoj shqyrtimi i rasteve dhe inventarizimi i mbetjeve mortore që ruhen në DML. Ekipi vendor për zhvarrime i themeluar nga EULEX-i dhe Ministria e Drejtësisë (MD) do të jetë shumë më aktivë në terren.

Si në vitet e kaluara, sfidat më të mëdha për vitin 2012 janë: gjetja e **informatave të besueshme** që shpien në lokacionin e varrezave të mundshme, përcaktimi i identitetit të mbetjeve mortore që mbahen në DML. EULEX-i do të vazhdojë të ndihmojë në zhvillimin e kapaciteteve mjeko-ligjore vendore.

KAPITULLI 1 – OPERACIONET PËR PERSONAT E ZHDUKUR

1.1 REZULTATET NGA OPERACIONET FUSHORE

EULEX-DML ka ndërmarr një sezon intensive fushore me gjithsej **84 operacione në terren** duke rezultuar në gjetjen e **42 individëve.**

Harta dhe tabelat në vijim paraqesin shpërndarjen gjeografike të operacioneve në terren të ndërmarra në vitin 2011:

HARTA 1- NUMRI I OPERACIONEVE FUSHORE DHE INDIVIDËT E GJETUR SIPAS REGJIONEVE




Tabela 1: Operacionet fushore sipas regjioneve

Regjioni	Operacionet fushore	Individët e gjetur
Mitrovicë	23	16
Prishtinë	3	0
Gjilan	3	2
Peja	10	3
Prizren	12	3
Ferizaj	3	1
Gjakovë	16	17
Gjithsej	70	42

Tabela 2: Operacionet fushore sipas komunave

Komuna	Operacionet fushore	Individët e gjetur
Deçan	2	0
Gjakovë	9	11
Ferizaj	1	0
Gjilan	3	2
Istog	5	1
Kaçanik	2	1
Klina	3	1
Malishevë	1	2
Mitrovicë	16	12
Podujevë	1	0
Pejë	2	1
Prishtinë	2	0
Prizren	9	1
Rahovec	6	6
Skenderaj	1	1
Suharekë	3	0
Vushtrri	4	3
Gjithsej	70	42

Përfaqësuesit e EULEX-it dhe DML-së kanë marrë pjesë si vëzhgues në vlerësimin e këtij vendi në Serbi:

Tabela 3: Vendndodhjet e vizituara si vëzhgues

Vendndodhja e pretenduar	Data	Statusi
Medvegja	29 prill	Negativ

EULEX-i do të vazhdoj të kërkoj nga autoritetet serbe që në mënyrë shkencore dhe sistematike duke përdorur metodologjinë dhe teknikat adekuate t'i kontrollojë vendet e mundshme, siç është Rudnica.

Tabela 4- Operacionet fushore të kryera në vitin 2011

Data	Lokacioni	Fshati	Komuna	Lloji i aktivitetit	Të gjetur
11-jan-11	Xhamia e Ibrit	Mitrovica -V	Mitrovicë	Hulumtim	KHM
17-jan-11	Xhamia e Ibrit	Mitrovica -V	Mitrovicë	Vizitë tek AF dhe vendndodhjes	KHM
18-jan-11	Tusus	Prizren	Prizren	Vlerësim i terrenit	KHM
27-jan-11	Bardoniç	Bardoniç	Gjakovë	Mbledhja e informatave	KHM
02-shk-11	Varrezë në Billushë	Billushë	Prizren	Vlerësim i terrenit	KHM
09-mar-11	Poligon i Gjuajtjes	Lubizhdë	Prizren	Vlerësim i terrenit	KHM
10-mar-11	Shtëpi e shfrytëzuar si qendër mbajtjeje	Zllash	Prishtinë	Vlerësim i terrenit	KHM
15-mar-11	Xhami në Mitrovicë-J	Mitrovica-J	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
15-mar-11	Varrezë myslimane në Mitrovica- V	Mitrovica -V	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
15-mar-11	Varrezë myslimane në Mitrovica- V	Mitrovica-V	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
16-mar-11	Varrezë myslimane në Mitrovica- V	Mitrovica-V	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
17-mar-11	Fushë	Drenovcë	Klinë	Gërmim në terren	0
18-mar-11	Xhamia në Mitrovicë- J	Mitrovica-J	Mitrovicë	Zhvarrim në terren	1
22-mar-11	Fushë	Treboviq	Pejë	Zhvarrim në terren	1
23-mar-11	Zabel	Doganaj	Kaçanik	Gërmim në terren	0
28-mar-11	Fushë	Dejnë	Rahovec	Vlerësim i terrenit	0
29-mar-11	Varrezë	Brekovc	Gjakovë	Marrje e mostrës	1
31-mar-11	Varrezë Ortodokse	Srbica e Ulët	Prizren	Konfirmim identiteti	1
05-pri-11	Varrezë	Suhareke	Suharekë	Vlerësim i terrenit	0
06-pri-11	Shtëpi e shfrytëzuar si qendër mbajtjeje	Zllash	Prishtinë	Vlerësim i terrenit	KHM
07-pri-11	Varrezë e Dëshmorëve	Postasell	Rahovec	Zhvarrim në terren dhe pranim-dorëzimi	3
12-pri-11	Xhami	Mitrovica –J	Mitrovicë	Gërmim në terren	0
12-pri-11	Xhamia e Ibrit	Mitrovica -V	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
18-pri-11	Varrezat e Tususit	Prizren	Prizren	Gërmim në terren	0
26-pri-11	Varrezë Luftë	Vidomiriç	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
27-pri-11	Varrezë e Dëshmorëve	Studime	Vushtrri	Zhvarrim në terren	2
05-maj-11	Bunar	Pejë	Pejë	Vlerësim i terrenit	KHM

10-maj-11	Pendë Liqeni	Livoç	Gjilan	Vlerësim i terrenit	0
11-maj-11	Minierë Ligniti	Zhilivodë	Vushtrri	Gërmim në terren	KHM
19-maj-11	Varrezë	Grabc	Klinë	Zhvarrim në terren	2
24-maj-11	Luginë e thellë	Budakovë	Suharekë	Vlerësim i terrenit	KHM
26-maj-11	Varrezë e Dëshmorëve	Stanovc	Vushtrri	Zhvarrim në terren dhe pranim-dorëzimi	1
31-maj-11	Varrezë myslimane-pjesa e poshtme	Mitrovica –V	Mitrovicë	Konfirmim identiteti	1
31-maj-11	Varrezë myslimane-pjesa e poshtme	Mitrovica -V	Mitrovicë	Zhvarrim në terren	2
01-qer-11	Varrezë myslimane-pjesa e poshtme	Mitrovica -V	Mitrovicë	Zhvarrim në terren	1
02-qer-11	Varrezë myslimane-pjesa e epërme	Mitrovica –V	Mitrovicë	Zhvarrim në terren	4
07-qer-11	Varrezë myslimane-pjesa e epërme	Mitrovica -V	Mitrovicë	Zhvarrim në terren	1
14-qer-11	Varrezë e dëshmorëve	Zatriq	Rahovec	Zhvarrim në terren	1
16-qer-11	Varrezë Qyteti	Brekovc	Gjakovë	Zhvarrim në terren	1
16-qer-11	Varrezë Qyteti 01 dhe 03	Brekovc	Gjakovë	Zhvarrim në terren	2
21-qer-11	Varrezë Qyteti 01 dhe 02	Brekovc	Gjakovë	Zhvarrim në terren	3
23-qer-11	Varrezat e Tususit	Prizren	Prizren	Gërmim në terren	0
27-qer-11	Poligon i Gjuajtjes	Lubizhdë	Prizren	Vlerësim i terrenit	KHM
28-qer-11	Varrezë e dëshmorëve	Qabrat	Gjakovë	Vlerësim i terrenit	0
30-qer-11	Oborr	Ferizaj	Ferizaj	Gërmim në terren	0
05-korr-11	Breg lumi	Pogragjë	Gjilan	Vlerësim i terrenit	1
06-korr-11	Pyll	Capar	Gjilan	Vlerësim i terrenit	1
19-korr-11	Varrezë	Brekovc	Gjakovë	Zhvarrim në terren	1
26-korr-11	Fabrika e Ballkanit	Suharekë	Suharekë	Gërmim në terren	0
03-gush-11	Varrezë	Rakosh	Istog	Zhvarrim në terren	1
04-gush-11	Varrezë	Rakosh	Istog	Gërmim në terren	0
17-gush-11	Varrezë	Rakosh	Istog	Gërmim në terren	0
18-gush-11	Varrezë	Rakosh	Istog	Gërmim në terren	0
22-gush-11	Varrezë	Krushë e Vogël	Prizren	Gërmim në terren	0
08-shta-11	Shpat Kodre	Medvegjë		Gërmim në terren	0
09-shta-11	Shpat Kodre	Medvegjë		Gërmim në terren	0
13-shta-11	Fushë	Rahovec	Rahovec	Gërmim në terren	0
13-shta-11	Vreshta	Rahovec	Rahovec	Gërmim në terren	0
20-shta-11	Tokë e shpyllëzuar	Ternavë	Podujevë	Gërmim në terren	0

22-shta-11	Varrezë fshati	Vermicë	Malishevë	Konfirmim identiteti	2
27-shta-11	Pyll	Kosharë	Deçan	Vlerësim i terrenit	0
04-tet-11	Varrezë e Dëshmorëve	Pastasell	Rahovec	Konfirmim identiteti	2
06-tet-11	Varrezë e Dëshmorëve	Aqarevë	Skenderaj	Konfirmim identiteti	1
11-tet-11	Varrezë	Shupkoc	Mitrovicë	Konfirmim identiteti	2
13-tet-11	Varrezë	Brekoc	Gjakovë	Zhvarrim në terren	3
19-tet-11	Buzë rruge	Mitrovica -J	Mitrovicë	Vlerësim i terrenit	KHM
10-nën-11	Fushë	Kalavaj	Deçani	Gërmim në terren	0
15-nën-11	Fushë	Soponicë	Kacanik	Konfirmim identiteti	1
17-nën-11	Varrezë	Mlikë	Dragash	Vlerësim i terrenit	KHM
21-nën-11	Bunar	Klinovac	Klinë	Gërmim në terren	0

KHM-Kërkohet hulumtim i mëtejshëm

Tabela 4 paraqet 70 operacionet në terren të cilat çuan ose do të çojnë në gërmime/zhvarrime. Janë edhe 14 operacione fushore shitesë që nuk janë futur në këtë listë e që për shkak të natyrës së tyre nuk mund të përfshihen në këtë raport.

KAPITULLI 2- REZULTATET E ANTROPOLOGJISË MJEKO-LIGJORE DHE TË IDENTIFIKIMIT

2.1 Identifikimi: Si rezultat i punës për identifikim të kryer në EULEX-DML, janë identifikuar 79 persona dhe u janë kthyer familjeve përkatëse. **51 nga këta** kanë qenë në listën zyrtare të KNKK-së për personat e zhdukur.

2.2 Ribashkimet: Si rezultat i punës së antropologjisë mjeko-ligjore janë përzgjedhur 278 mostra eshtërore për analiza të mëtejshme përfshirë edhe profilizimin gjenetik të kryer nga KNPZH-ja. Gjithashtu, 219 mostra eshtërore janë ribashkuar me mbetjet mortore të individëve paraprakisht të identifikuar.

2.3 Rastet e përziera dhe të djegura: Janë kryer analiza dhe vlerësime të detajuara të disa rasteve të mbetjeve mortore të përziera dhe të djegura nga disa regjione të Kosovës. Detyrë identike është kryer edhe me mijëra pjesë trupore të fragmentuara të zhvarrosura nga lokacionet në Serbi (Bajna Bashtë, Petrovosellë dhe Batajnicë). Kjo punë është kryer së bashku me rishqyrtimin e mbi 700 dosjeve.

2.4 Mbetjet e panjohura mortore: Identifikimi i trupave dhe i pjesëve të trupit që ruhen në DML është i prioritetit më të lartë dhe përbën një komponentë themelore të strategjisë së EULEX-DML-së. Për këtë qëllim, EULEX-DML ka punuar në mënyrë intensive në shqyrtimin e secilit rast veç e veç duke bërë përparim të konsiderueshëm. Kjo detyrë ka kërkuar shumë punë intensive dhe ka qenë tejet komplekse. Rishqyrtimi i rasteve do të përfundoj në vitin 2012.

Tabela 5: NN sipas Komunave

Komuna	Skelete	Pjesë skeleti
Deçan	2	9
Gjakovë	25	12
Ferizaj	3	0
Gjilan	2	1
Drenas	1	1
Istog	2	17
Kaçanik	4	1
Kamenicë	2	0
Klinë	3	0
Lipjan	0	1
Malishevë	3	1
Mitrovicë	23	8
Podujevë	2	1
Pejë	22	18
Prizren	32	7
Prishtinë	82	9
Rahovec	8	2
Skenderaj	3	7
Suharekë	14	2
Vushtrri	12	2
Gjithsej	245	99

Tabela 6: NN sipas Regjioneve


Regjioni	Skelete	Pjesë skeleti
Mitrovica	38	17
Prishtina	85	12
Gjilan	4	1
Peja	27	35
Prizren	49	10
Ferizaj	7	1
Gjakova	35	23
Gjithsej	245	99

Tabela 7: NN nga vendndodhjet në Serbi

Vendndodhja	Pjesë skeleti
Banja Bashta	3
Batajnica	6
Batajnica 03	2
Batajnica 05	7
Batajnica 07	5
Gjithsej	23

Tabela 7 paraqet numrin e pjesëve skeletore, nga varrezat masive që ndodheshin në Serbi në vitet 2001, 2002 dhe 2003, pa përputhje të ADN-së. Gjithsej edhe 23 profile unike (23 individë) mbesin për tu identifikuar.

HARTA 2- SKELETET DHE PJESE SKELETORE TË GJETURA SIPAS REGJIONEVE



2.5 Identifikimet e gabuara: është bërë hulumtim në fushat e poshtëshënuara (tabela 8) lidhur me keq-identifikimet e mundshme të bëra gjatë viteve 1999 dhe 2000.

Tabela 8: Aktivitetet që kanë trajtuar identifikimet e gabuara

Aktivitetet	Komente
Inspektim i arkivave	MPB, TPNJ, KFOR, NJPZh, dhe ZPZhML dokumentet e rishikuara për vendndodhjet në objektiv (p.sh . Pastasellë dhe Studime)
Takimet e përgjithshme	10 takime me asociacionet e familjeve
Detyrat fushore	45 familje janë intervistuar dhe iu është kërkuar që të dhurojnë gjak për mostrim
Operacionet fushore	14 zhvarrime
Studimet statistikore	Krahasimi tabelor i të dhënave relevante dhe zhvillimi i sistemit të gjetjes për gjitha rastet e zhvarrosura nga TPNJ-së në vitet 1999 dhe 2000

KAPITULLI 3- TË ZHDUKURIT: RAPORTI I SITUATËS

Tabela 9- Numri i të Zhdukurve sipas komunave (deri në dhjetor 2011)

Komuna	# i PZh
Deçan	114
Gjakovë	211
Ferizaj	34
Gjilan	32
F/Kos.	20
Drenas	65
Istog	66
Kaçanik	16
Kamenicë	6
Klinë	80
Lipjan	16
Novo Bërdë	5
Malishevë	34
Mitrovicë	71
Obiliq	14
Podujevë	37
Pejë	139
Prizren	176
Prishtinë	99
Rahovec	143


Skenderaj	118
Z/Potok	24
Shtimje	16
Shtërpc	5
Suharekë	141
Viti	5
Vushtrri	37
Zvecan	3
Tjera*	63
Gjithsej	1790

(* "Tjera" i referohet lokacioneve të panjohura dhe atyre të huaja që janë par së fundi)

Grafiku në vijim paraqet një përafrim të shpërndarjes së personave të zhdukur sipas ngjarjeve specifike apo kategorive të rasteve. Numri i përafërt i viktimave sipas kategorisë zbritet nga; fillimisht nga numri i përgjithshëm i personave ende të zhdukur që nga dhjetori 2011 (dmth. 1790). Prandaj, 1790-300 raste të djegura = 1490; 1490-300 raste të Rashkës =

1190, dhe kështu me radhë deri sa të arrihet numri thelbësor i rasteve të të zhdukurve. Në këtë rast, 428 për shqiptarë të Kosovës dhe 450 për joshqiptarë. Kjo paraqet gjithsej 878 raste të cilat mbesin për tu kategorizuar.

Grafiku 1: Shpërndarja sipas Kategorive të rastit



Ka shumë gjasë që këto 878 raste të jenë të përfshira në këto kategori rastesh: varrezat në Kosovë; varrime joformale, varrime klandestine dhe NN të mbajtura në DML. Nuk janë përfshirë rastet e identifikimeve të gabuara (shih tekstin e mëposhtëm për shpjegim).

Grafiku 2: Kategoritë e rasteve




Tabela 10: Kategoritë e rasteve

Kategoria e rasteve	Strategjia e hetimeve	Burimi kryesor i informatave	Shembulli
Varrezat (janë mbi 20,000 në Kosovë)	Mbledhja e gjitha shënimeve ekzistuese, krahasimi tabelor dhe rikonstruimi i ngjarjeve/periudha kohore)	Hartat serbe dhe të TPNJ-së, skicat, fotot dhe rrëfimet	Brusnik, Novollan, Mitrovica-V
Varrime joformale	Intervistat dhe mbledhja e dëshmimeve, testet e besueshmërisë, operacionet fushore	Informator	Zgatar
Varrime klandestine	Intervistat dhe mbledhja e dëshmimeve, testet e besueshmërisë, operacionet fushore	Informator, dokumente	Kleçka, Krusha e Madhe
NN të mbajtur në DML-ë	Rishikimi i dosjeve të rasteve, ekzaminimi i mbetjeve njerëzore, rikonstruimi i ngjarjeve, takim me familjet e shënuara, operacionet fushore, puna në identifikimin e njerëzve	TPNJ dhe dokumente tjera, familjet	Pastasellë, Studime, Matiqan

Mbi 70% e zhvarrimeve të kryera nga EULEX-DML gjatë tre viteve të fundit janë ndërmarr në varrezat në Kosovë. Një pjesë e madhe e personave të zhdukur janë gjetur në varret NN brenda këtyre varrezave. Prandaj, siç të dhënat tregojnë, ka shumë gjasë që një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve ende të pagjetur janë të varrosur në këtë kontekst. Në Kosovë janë mbi 20.000 varreza. Megjithatë, hulumtimet arkivore që janë kryer nga EULEX-DML ka bërë që ky numër të ngushtohet në mënyrë të konsiderueshme.

Ky fenomen nuk vlen për të zhdukurit joshqiptarë. Të dhënat indikojnë se një pjesë e madhe e tyre mund të jenë të varrosur në varreza klandestine gjithandej në Kosovë.

Identifikimet e gabuara: Shkalla e problemit dhe lidhshmëria e saj me çështjen e personave të zhdukur:

Që nga viti 2003, ZPZHML (tani EULEX-DML) ka zhvarrosur një numër të madh të mbetjeve mortore të cilat paraprakisht ishin të njohura nga familjarët dhe të cilët u varrosën si individë të NJOHUR. Shumë zhvarrime të mëvonshme janë kryer me kërkesë të familjeve të njëjta të cilat dyshonin nëse i kanë varrosur mbetjet e sakta mortore.

Fillimisht, dokumentacioni përkatës i 1180 rasteve për identifikime të gabuara u shqyrtua duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Data e ngjarjes
- Natyra e ngjarjes (prita, pika-kontrolli, bombardim i fshatrave, etj)
- Numri i viktimave si pasojë e ngjarjeve
- Niveli i dekompozimit i mbetjeve mortore kur fillimisht ato ishin varrosur
- Kush ka pohuar se i ka njohur mbetjet mortore dhe mbi çfarë baze?
- Kush i kishte varrosur mbetjet mortore?

Gjithashtu, që nga viti 2003 ZPZHML dhe pastaj EULEX-DML zhvarrosi pothuajse 200 raste me qëllim të testimit të shkallës së gabimeve të mundshme të bëra në vitin 1999, 2000 dhe 2001. Për këtë detyrë, më shumë se shtatë grupeve të dhënash janë krahasuar në mënyrë tabelore duke rezultuar në një sistem përcjellës i cili përcjell viktimat e emëruar nga viti 1999 deri në pikën në të cilën mbetjet mortore ishin ri-zhvarrosur dhe identifikuar shkencërisht.

Është bërë e ditur se shkalla aktuale e identifikimeve të gabuara është më e vogël se sa pritej më parë. Rezultatet statistikore paraqesin se rreth 9 % të rasteve të kontrolluara ishin identifikuar gabimisht. Brenda këtij grupi ka pasur identifikime të gabuara “të brendshme”. Kur identifikimet e gabuara të “brendshme” hiqen nga ekuacioni, përqindja e identifikimeve të gabuara që përfshinë personat e zhdukur faktikisht zbrit në 6.6% (identifikimet e gabuara të brendshme i referohet rasteve ku për shembull dy vëllezër të cilët vdiqën në të njëjtën ngjarje u varrosën nën emrin e njëri-tjetrit; por asnjëri prej tyre nuk u raportua i zhdukur; me fjalë të tjera, kur një familje ka të gjitha viktimat e gjetura por të varrosur me emrat e gabuar).

Prandaj nuk është e vlefshme që ky 6.6% ti aplikohet numrit të përgjithshëm të personave ende të pagjetur (1790) pasi që, siç paraqitet në grafikun 1, dihet se mbetjet mortore të shumë viktimave janë djegur ose varrosur në varreza masive të cilat duhet gjetur edhe në Kosovë dhe jashtë saj.

Gjithashtu, kur 6.6% i aplikohet 420 shqiptarëve* të zhdukur, do të pasqyrojë se vetëm 30 persona të zhdukur janë varrosur nën emrin e gabuar. Kur 6.6% e paraqesim në të gjitha rastet e “identifikuara” të cilat janë zhvarrosur nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në vitin 1999 dhe 2000, (korrigjimi i gërshetimeve vjetore dhe 200 rasteve tashmë të kontrolluara) rezultati del se 70 persona potencialisht janë identifikuar gabimisht. Prandaj ne parashohim se një numër nga 30 deri në 70 persona të zhdukur mund të jenë varrosur nën emrin e gabuar. Të dhënat qartë paraqesin se fenomeni i identifikimeve të gabuara ishte i kufizuar dhe ka ngjarë nën kritere të veçanta (të përshkruara më lart).

Duke shfrytëzuar këto kritere, DML është drejtuar në varrezat dhe ngjarjet specifike të cilat janë të ndërlidhura me ngjarjet si ajo e Shtudimes dhe Pastasellit. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në raportin vjetor të DML të vitit 2010.

(Të dhënat në dispozicion fuqimisht sugjerojnë se çështja e identifikimeve të gabuar nuk vlen për rastet me jo-shqiptar).*

KAPITULLI 4- MONITORIMI, UDHËZIMI DHE KËSHILLIMI (MUK) DHE NGRITJA E KAPACITETEVE VENDORE NË DML

Është e rëndësishë vendimtare që DML-ja të vazhdojë zhvillimin e kapaciteteve vendore të mjekësisë ligjore për të vazhduar punën në përcaktimin e fatit të të zhdukurve atëherë kur EULEX-i të largohet nga Kosova.

Ekspertët mjeko-ligjor të EULEX-it në mënyrë aktive kanë këshilluar dhe udhëzuar stafin vendor të MD/DML në përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë edhe krijimin e një ekipi vendor për zhvarrime (shih aneksin 2) dhe një ekip tjetër të ndarë i përkushtuar që të punoj në çështjet e rasteve të identifikimeve të gabuara dhe komunikimin me familjet.

Ekipi vendor për zhvarrime në mënyrë aktive ishte i pranishëm dhe i angazhuar në më shumë se 30 operacione në terren. Çështja e identifikimeve të gabuara të mundshme ka qenë një aspekt i rëndësishëm në DML që kur misioni i EULEX-it filloi së funksionuari tri vite më parë. Në vitin 2011, ekipi i EULEX-DML filloi Monitorimin, Udhëzimin dhe Këshillimin (MUK) e ekipit për komunikim me familje pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'u marrë me rastet e veçanta të identifikimeve të gabuara në terren.

Familjet janë vizituar në mënyrë sistematike të cilave u është kërkuar që të japin informacione shtesë si dhe mostra të gjakut për analizat e ADN-së. Raste të tjera kanë të bëjnë me familjet të cilat kërkojnë zhvarrime dhe identifikim përmes analizave antropologjike dhe të ADN-së, para së cilave duhet marrë informacione të detajuara nga familja në mënyrë që të mund të vazhdohet me zhvarrim.

Janë mbajtur takime të rregullta në të cilat ekipi për komunikim me familje u informua për raste të ndryshme, deri më tani progresi dhe hetimet janë ende në pritje. Detyrat e përbashkëta fushore filluan në muajin maj. Që atëherë, në rajone të ndryshme të Kosovës janë intervistuar mbi 60 familje duke përfshirë edhe Rahovecin, Vushtrrinë, Skenderajn. Njëzet prej detyrave të caktuara janë kryer nga ekipi i MD-së për komunikim me familje në mënyrë të pavarur dhe të suksesshme.

KAPITULLI 5 – PLANI I PUNËS 2012

EULEX-DML përpiket që MD-së t'ia transferoj plotësisht operacionet për personat e zhdukur kur EULEX-i të jetë i kënaqur se detyrat e ndërlikuara mund të kryhen në mënyrë profesionale, shkencore dhe të paanshme. Një pjesë e madhe e punës tashmë menaxhohet nga MD-ja. Të gjitha informatat që paraqiten nga EULEX-DML e që nuk janë të ndjeshme ndahen me drejtorin vendor dhe stafin përkatës. Megjithatë, nuk ka ende kapacitete vendore plotësisht funksionale që të merren me hetimet e rasteve, zhvarrimet dhe punën antropologjike. Në vitin 2012, EULEX-DML fuqimisht do të vazhdoj të inkurajoj MD-në që të zhvilloj kapacitet e nevojshme vendore që në mënyrë të përgjegjshme të merret me operacionet për personat e zhdukur.

4.1 Operacionet fushore të projektuara (n=36):

Lokacioni	Komuna	Lloji i vendndodhjes	PZh/RDiIG	# i individëve
Qabrat	Gjakovë	Varrezë	Ribashkim	19+
Stupel	Kline	Varrezë	RDiIG	1
Nabërgjan	Pejë	Varrezë	RDiIG	1
Pastasellë	Rahovec	Varrezë	RDiIG	56
Makërmal	Skenderaj	Varrezë	RDiIG	15
Strellc	Deçani	Varrezë	PZh	1
Ramoc	Gjakovë	E panjohur	PZh	3
Koretishtë	Gjilan	Bunar	PZh	2
Vlladovë	Gjilan	E panjohur	PZh	3
Dobërçan	Gjilan	E panjohur	PZh	1
Petrovc	Gjilan	E panjohur	PZh	1
Vllashticë	Gjilan	E panjohur	PZh	2
Llugovë	Istog	Fushë	PZh	3
Bratillovë	Kamenicë	Fushë	PZh	1
Qabiq	Klinë	Bunar	PZh	1
Dobërdol	Klinë	Varrezë	PZh	1
Bicaj	Klinë	Fushë	PZh	5
Kamen	Leposaviq	Fushë	PZh	1
Mitrovicë-V	Mitrovicë	Xhami	PZh	1+
Suhodoli	Mitrovicë	Varrezë	PZh	1
Obiliq Centrali Elelktirik	Obiliq	Fushë	PZh	15
Pejë	Pejë	Bunar	PZh	1
Dubocak	Pejë	Fushë	PZh	1+
Lladovc	Podujevë	Bunar	PZh	2
Gorozhub	Prizren	Fushë e hapur	PZh	24
Poligon i gjuajtjes	Prizren	Fushë	PZh	rreth 80
Mamushë	Prizren	Varrezë	PZh	3
Rudnicë	Serbi	Gurore	PZh	rreth 300
Prekaz i Epërm/Ulët	Skenderaj	Varrezë	PZh	2
Zhivilodë	Vushtrri	Minierë	PZh	26
Sllakovcë	Vushtrri	Fushë	PZh	2
Skroma	Vushtrri	Breg lumi	PZh	8
Kunovik	Vushtrri	Buzë rruge	PZh	1
Dren	Zubin Potok	Fushë	PZh	26
Vidomiriq	Zvecan	Fushë	PZh	1
Klinovc	Klinë	Bunar	PZh	1

1. PZh: Rast i personave të zhdukur; RDilG- Rast i dyshuar i Identifikimit të Gabuar
2. Jo gjithë operacionet fushore çuan në zhvarrime.
3. Kushtet atmosferike të pafavorshme mund të pengojnë të kryhen disa operacione fushore.
4. Rastet e reja mund të dalin në pah dhe do të jenë prioritare.

- EULEX-i do të vazhdoj të ndërmarr veprime që kanë për synim lokalizimin dhe gjetjen e vendëvarrezave të dyshuara përtej kufijve të Kosovës.
- “Projekti shtëpia e djegur” – shumë persona të zhdukur ishin individë të moshuar të cilët ngelën në shtëpi gjatë dhe menjëherë pas konfliktit. Shumë nga këto shtëpi u shkatërruan. Është e mundshme që disa viktima janë të varrosura në këto rrënoja.
- Në koordinim me organizatat relevante, veçanërisht KNPZH, të mblidhet sa më shumë gjak ose/dhe mostra të eshtrave në mënyrë që profilet e pjesshme të ADN-së të kompletohen.
- Të përfundoj rishikimi i rasteve të mbetjeve të panjohura NN të ruajtura në DML.
- Të mbyllen rastet të cilat kanë arritur kufijtë e analizave mjekoligjore.
- Të këshilloj dhe udhëzoj MD-në në implementimin e një trajnimit intensiv të fokusuar në fushat përkatëse të mjekësisë ligjore (shih aneksin 2: MUK i ekipit vendor te DML-së për zhvarrime).

KAPITULLI 6- REKOMANDIMET:

EULEX-DML shfrytëzon rastin që respektivisht t’i bëjë rekomandimet e poshtëshënuara akterëve kryesor në çështjen e personave të zhdukur.

Për Zyrën e Kryeministrit të Kosovës:

1. Përfundoni Komisionin Qeveritar për Personat e Zhdukur. Ka pasur ndryshime të rëndësishme por ka nevojë të bëhet më shumë për ti mundësuar KQPZH-së në përmbushjen e mandatit të tij. Është i nevojshëm të bëhet vlerësim i aktiviteteve, burimeve njerëzore, strukturës organizative dhe nevojave buxhetore.
2. Mblidhni informacione lidhur me lokacionet e vendëvarrezave me të zhdukur joshqiptar. Paraqisni këto informata tek Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq.
3. Filloni përpjekjet për pajtim të vërtetë. Dihet mirë se iniciativat për pajtim qojnë tek lokacioni i varrezave, gjegjësisht tek personat e zhdukur.
4. Filloni me projektet memoriale për të zhdukurit së bashku me caktimin e vendeve posaçërisht për varrosjen e mbetjeve mortore të pidentifikuara.
5. Të siguroj që Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë së Kosovës të vazhdoj mbështetjen logjistike dhe operacionale për fazën **përfundimtare** (para-mjeko-ligjore) të gërmimit në Zhilivodë.

Për Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës:

1. Mbështesni Departamentin e Mjekësisë Ligjore. Departamenti në mënyrë urgjente ka nevojë për mbështetje logjistike, administrative dhe të burimeve njerëzore. Nuk mund të pritët që ai të jap rezultate në qoftë se ajo nuk është në gjendje të punoj në drejtim të tyre.
2. Kontribuoni në zhvillimin e kapaciteteve vendore të mjekësisë ligjore: Kosova ka nevojë për antropolog dhe arkeolog vendor mjeko-ligjor. EULEX-i nuk mund ta bëjë këtë trajnim i vetëm.
3. Në Kosovë çdo vit zbulohen shumë mbetje arkeologjike njerëzore. Duhet hartuar legjislacioni i duhur që në mënyrë etike të merret me mbetjet mortore njerëzore që nuk janë në rëndësi të mjekësisë ligjore.

Për MD/Departamentin e Mjekësisë Ligjore:

1. Rrisni mbështetjen për ekipin e identifikimit dhe njësisë për komunikim. Numri i stafit është i pamjaftueshëm andaj nuk mund të përmbushen detyrat në kohën e duhur.
2. Mbështesni dhe formalisht themeloni ekipin për zhvarrime. Ky ekip do të jetë vendimtar kur EULEX-i të dorëzojë përgjegjësitë.
3. Përmirësoni komunikimin mes njërive duke mbajtur takime të rregullta të bashkërenduara dhe duke bërë vlerësimin e planeve të veprimit.

Për Qeverinë e Serbisë:

1. Rrisni përpjekjet për lëshimin e dokumenteve të MPB-së dhe ish-Forcave të Armatosura Jugosllave të viteve 1998 dhe 1999 lidhur me vendvarrezat dhe ngjarjet të ndëlidhura me konfliktin në Kosovë. Këto dokumente janë të një rëndësie jetike për zgjidhjen e disa rasteve të personave të zhdukur.
2. Bëni vlerësimin e varrezës së dyshuar masive në Rudnicë (Rashkë) pa vonesë të mëtejshme.
3. Filloni përpjekjet për pajtim të vërtet. Dihet mirë se iniciativat për pajtim qojnë drejt tek lokacioni i personave të zhdukur.

Për Shoqatat e Familjeve:

1. Rifokusoni ndërhyrjet tuaja. Mbani trysni në të dy qeveritë për të zgjidhur këtë çështje.
2. Mbani çështjen e të zhdukurve në mendjen e publikut. Ngritni vetëdijësimin.
3. Zhvilloni aktivitete multietnike. Këto mund të jenë më shumë efektive.
4. Mbështesni Grupin Punues të KNKK-së për Personat e Zhdukur. Insistoni që të dy delegacionet, ajo e Prishtinës dhe e Beogradit, të sigurojnë informacione të besueshme.

Për Komandën e KFOR-it:

1. Bëni fotografimin ajror, bëni që raportet tjera të situatave në lidhje me zbulimin e varrezave në vitin 1999 dhe tutje, të jenë në dispozicion të DML-së. Ky mund të jetë një mjet shumë i çmuar për operacionet tona.

Për shtetet anëtare të BE-së:

1. Në mënyrë aktive të inkurajojnë Beogradin dhe Prishtinën t'i rrisin përpjekjet e tyre për të përcaktuar fatin e të zhdukurve. BE-ja, nëpërmjet ekspertëve të saj të mjekësisë ligjore në DML, është plotësisht e angazhuar dhe e përkushtuar për këtë çështje. Këto përpjekje duhet të jenë reciproke.

ANEKSI 1- MANDATI I EULEX/DML

EULEX-i është Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, i themeluar me 4 shkurt 2008 me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP. Misioni u miratua nga Qeveria e Kosovës dhe 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, me mandatin që t'i ndihmoj organet gjyqësore të Kosovës dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë. Ky mision filloi së funksionuari më 9 dhjetor të vitit 2008.

Në qershor të vitit 2010, në pajtim me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-137 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ZPZHML u shndërrua në "Departament të Mjekësisë Ligjore" nën Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. DML ishte themeluar "si organ publik kompetent përgjegjës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore dhe hetime mjekësore mbi vdekjen, duke përfshirë zhvarrosjen e mbetjeve mortore nga konflikti në Kosovë dhe kthimin e mbetjeve mortore tek familjet përkatëse".

Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) është institucion shkencor i Ministrisë së Drejtësisë i specializuar në fusha të ndryshme mjeko-ligjore. Objektivat kryesore të tij janë:

- Të përcaktojë fatin e personave të zhdukur si pasojë e konfliktit në Kosovë dhe pas tij,
- Forcimin e Sundimit të Ligjit në Kosovë duke dhënë dëshmi fizike shkencërisht të shëndosha që mund të japin ndihmë në kërkim të drejtësisë,
- Të jetë mu në ballë të zhvillimeve që lidhen me mjekësinë ligjore në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit.

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it punojnë përkrah me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë në DML për të ndihmuar në kërkimin e personave të zhdukur dhe për të zhvilluar një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv në kuadër të sistemit mjeko-ligjor. Që nga data 9 dhjetor 2008, EULEX-i filloi procesin e Monitorimit, Udhëzimit dhe Këshillimit (MUK) dhe funksionet ekzekutive në DML. Për ta përmbushur mandatin e tyre, ekspertët e EULEX-it punojnë në bashkëpunim të plotë me partnerët e tyre nga DML në Ministrinë e Drejtësisë.

DML ka këtë mandate të dyfishtë:

1) Të zbardhë fatin e personave të zhdukur:

- Të vlerësoj dhe zhvarros varrezat e dyshuara
- Të kryej autopsitë e mbetjeve të paidentifikuara për të përcaktuar shkakun e vdekjes kur kjo gjë është e mundur dhe te kryej identifikimin në mënyrë profesionale duke përdorur analizën e ADN-së kur është e nevojshme,
- T'i informojë në vazhdimësi familjet e personave të zhdukur mbi progresin e arritur dhe t'ua kthej familjeve mbetjet e identifikuara mortore në kohë të duhur dhe mënyrë të respektuar,
- T'i azhurnojë shënimet dhe statistikatat mbi personat e zhdukur në Kosovë .

2) Të sigurojë një sistem mjeko-ligjor në Kosovë me standarde evropiane, duke përfshirë këto specializime, por jo enkas të kufizuar në to:

- Ekzaminimin mjekësor të viktimave të dhunës fizike/seksuale,
- Autopsitë në raste të vdekjeve të dyshuara jonatyrore,
- Rastet nga praktika neglizhuese mjekësore,
- Analizat toksikologjike,
- Analizat histopatologjike,

- Analiza mjeko-ligjore në vende të ngjarjeve.

DML ka krijuar një sistem koherent të procedurave të punës dhe protokolleve mbi zhvarrimet, autopsitë, identifikimin, kthimin e mbetjeve dhe punën në morg, gjë që respekton kushtet e sistemit gjyqësor dhe nevojat e familjeve.

Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur në Kosovë është një detyrë që ka rrugë tepër të gjatë dhe komplekse të cilën e rëndon në veçanti konteksti shoqëror dhe politik. Përmes auditimit sistematik të shënimeve, mbylljes së rasteve të personave që nuk janë më të zhdukur, hulumtimit të vazhdueshëm dhe rihapjes së varrezave, identifikimin dhe kthimin e mbetjeve mortore, numri i personave të zhdukur është zvogëluar nga 5236 (të dhëna nga qershori 2002) në 1790 (**të dhëna zyrtare në dhjetor të vitit 2011**).

1.1 RREGULLORJA E EULEX-DML LIDHUR ME QËSHTJEN E TË ZHDUKURVE:

Për EULEX-in dhe DML-në hetimi dhe zgjidhja e çështjes së të zhdukurve nga konflikti në Kosovë dhe në periudhën pas tij ka përparësi kryesore. Problemet e vështira që shoqërojnë rastet e personave të zhdukur kërkojnë një përgjigje të shpejtë, unike dhe të vazhdueshme. Hetimet, bashkë me aktivitetet informuese janë dhe do të jenë në kohë të duhur dhe gjithëpërfshirëse.

Ndërsa janë gjetur mbi 66% të të zhdukurve që nga data e lëshimit të këtij dokumenti, në Kosovë mbesin ende 1790 persona të pagjetur. Hetimet zakonisht ballafaqohen me raste që kryesisht u mungon drejtimi i hetimeve. Problemet e natyrës hetuese ngatërrohen me kalimin e kohës: shumica e zhdukjeve kanë ndodhur që prej një dekade. Komplexiteti i hetimeve shtron nevojën për përfshirje dhe bashkëveprim aktiv me/dhe përfshirjen e sektorëve relevant të shoqërisë civile në përpjekje për të krijuar shtigje të reja për zhvillimin e hetimeve.

Politikë e EULEX-DML është që të siguroj se:

- Të gjitha raportet hetohen plotësisht,
- Të krijohet një dosje complete e rastit dhe të azhurnohet kur sigurohen informata të reja,
- Të përdoret çdo mjet i nevojshëm në dispozicion të DML-së për të ndihmuar në zhvillimin e hetimit,
- Të bëhet çdo koordinim relevant me departamente tjera dhe njësitë relevante,
- Familjet e personave të zhdukur të informohen në vazhdimësi lidhur me zhvillimin e hetimeve. Të ndërmerren të gjitha përpjekjet për të risiguar familjet se po përdoren metodat e duhura hetuese dhe mjeko-ligjore.,
- Tu mundësohet qasja në informim familjeve dhe Shoqatave të Familjeve
- Të mbahen raporte adekuate dhe të sakta me media në lidhje me të zhdukurit dhe mbetjet e paidentifikuara mortore,
- Të mos mbyllet asnjë rast derisa të përcaktohet fati i personit të zhdukur.

ANEKSI 2: MONITORIMI, UDHËZIMI DHE KËSHILLIMI (MUK) I EKIPIT VENDOR TË DML-SË PËR ZHVARRIME

Në fillim të vitit 2011, arkeologu i DML-së u ngarkua me detyrë për mbajtjen e trajnimeve bazike (nën mandatin e MUK të EULEX-it) për katër zyrtarët vendor të DML (Departamenti i Mjekësisë Ligjore) për identifikim.


Qëllimi ishte dhe vazhdon të jetë që ekipit për zhvarrime t'i ofroj aftësitë e duhura që në mënyrë të standardizuar dhe profesionale të bazuara mbi metodologjinë ndërkombëtarisht të pranueshme ti qasen gjetjes së mbetjeve mortore njerëzore.

Trajnimi filloi më 7 prill 2011 me pjesëmarrjen e katër pjesëtarëve të cilët morën pjesë në zhvarrime të kombinuara dhe dorëzimin e mbetjeve njerëzore nga varrezat e dëshmorëve në Pastasell të komunës së Rahovecit.

Përfitimi kolektiv i përvojave

Nga muaji prill deri në dhjetor 2011, pjesëtarët e ekipit për zhvarrime kanë qenë të pranishëm në 36 ditë veprimtarie duke përfshirë:

- Rastet e dyshimta mbi identifikimet e gabueshme (6)
- Zhvarrime tjera (13)
- Vlerësime sipërfaqësore në teren (3)
- Vlerësime gërmuese në teren (14)



*Exc- Gërmim
A-Vlerësim
Exh-Zhvarrim
SMID-Identifikimet e gabuara të dyshuara*

Në këto raste arkeologu i DML-së ka mbajtur trajnim dhe ka udhëzuar pjesëtarët e ekipit për zhvarrime në zharrosjen e mbetjeve njerëzore nga varrezat formale e poashtu edhe në varrezat joformale në lokacionet me varreza dhe atyre pa varreza të ndërlidhura me luftën.

Në mënyrë kolektive dhe individuale ata kanë qenë të pranishëm në një varg të gjerë vendesh me prapavijë të ndryshme të rasteve për të fituar njohuri të strategjive të ndryshme të gjetjes së varreve. Si rezultat i kësaj është ata janë njoftuar mirë në lidhje me karakteristikat unike të një vendndodhje dhe çështjeve logjistike përkatëse.

Trajnimi kolektiv

Janë disa metoda bazë dhe qasje të zbatueshme për të gjitha situatat dhe këto janë ato për të cilat arkeologu i DML-së mban trajnim dhe ofron këshillime te cilat para së gjithash kanë të bëjnë me gërmimin dhe regjistrimin e të dhënave. Pikat e mëposhtme janë listuar në propozimin themelor për trajnimet bazë:

Kërkimi	Vlerësimi sipërfaqësor
Lokacioni	Gërmimi (hendekët/zona), interpretimi bazë i tokës
Gjetja	Gërmimi dhe gjetja e mbetjeve
Regjistrimi	Fotografitë; skicimi; forma përkatëse
Raportimi	Raporti zyrtar përfundimtar

Trajnimi/ Monitorimi Udhëzimi dhe Këshillimi (MUK) është zbatuar kryesisht nëpërmjet trajnimeve në fushë i plotësuar me dokumente dhe informacione bazë, të shkurtra dhe proformat që mund të përdoren si pika veprimi/shtytje e memories/shabllonë për marrjen e shënimeve në terren/harta etj. Trajnimi/Monitorimi Udhëzimi dhe Këshillimi (MUK) është ende në vazhdim.

Certifikimi

EULEX-DML nuk është në gjendje të siguroj certifikim formal të trajnimit apo ndonjë forme akreditimi kështu për këtë arsye është propozuar që njësisë për identifikim ti sigurohet trajnim relevant i përqendruar në mjekësi ligjore nëpërmjet serive punëtorish të mbajtura nga ekspertë nga/lidhur me ndonjë institucion akademik.

Qëllimi i punëtorive trajnuese është:

Të siguroj trajnim intensiv dhe akreditim themelor me një certifikatë formale

Punëtorit

Një kombinim i leksioneve joformale dhe skenave simuluese në natyrë që do të mbahen nga institucione të njohura të Mbretërisë së Bashkuar, në kohëzgjatje prej më shumë se një javë/10 ditë të përshtatura në mënyrë specifike për njësinë e identifikimeve. Kjo do të mundësoj vlerësimin e jashtëm, të pavarur nga praktikant të nivelit të lart. Kjo mund të plotësohet nga policë specifik të Kosovës/Prokuror të Kosovës/leksione nga EULEX-i për strukturën e policisë së Kosovës/Procedurat e dëshmime/urdhëresat gjyqësore/legjislacioni ne fuqi për mbetjet mortore njerëzore (nëse ka dhe nëse janë relevante) dhe mundësisht një ligjëratë të shkurtër për Ligjin për Personat e Zhdukur për të siguruar një paketë gjithëpërfshirëse.

Elementet për vlerësimin e certifikimit

Certifikimi mund të jetë për aktivitetet në terren dhe atyre në morg të ndërmarra nga njësi për identifikim.

Lënda	Elementet kryesore	Instruktorët	Mesatar
<i>Gërmimi</i>	Informimi për ndryshimet e dheut (natyrore dhe dheu çrregulluar); tiparet (prerë dhe tehe); gërmimi i mbetjeve njerëzore dhe artefaktet shoqëruese	Universiteti Dundee	Ligjëratë (a) Simulim i skenës
<i>Ekspertizë (Hulumtim)</i>	Skicimi i vendit (mbulim i gjerë i zonës; Bërja e matjeve – trekëndor dhe ofset; Vizatimi shkallor (përmasa) dhe vizatimi i hartës	Universiteti Dundee	Simulim i skenës
<i>Antropologjia fizike</i>	Informimi mbi elementet skeletore njerëzore ; shtazore dhe njerëzore;	Universiteti Dundee CAHID	Ligjëratë Simulim i skenës

	inventarizim bazik në vendndodhje		
Vendi i krimet	Nivelet e integritetit të vendndodhjes dhe qasja; procedurat dhe fotografimi në vendndodhje; Zinxhiri i ruajtjes së dëshmive	Universiteti Dundee	Ligjërata Simulim i skenës
Faktorët ligjor	Urdhëresa gjyqësore dhe hetimi; Rregullat e zbulimit dhe dëshmive; Policët vendor dhe ndërkombëtar	Prokuroria e Kosovës/PK/EULEX	Ligjërata
Aftësitë komunikuese	Komunikimi dhe puna ekipore në vendndodhje; raporti mbi vendndodhjen ; Dëshmitari Ekspert	Universiteti Dundee	Ligjërata ?Inskenim
Zhvillimi personal	Shëndeti dhe Siguria	Universiteti Dundee	Ligjërata